



11-05-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretarisht@kqz-ks.org, www.kqz-ks.org

Prishtinë / Priština  
Nr./Br. 437-2017

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, nenin 3.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2017, për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, më 11.05.2017, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z.NIKOLA TASIC** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Partesh, nga subjekti politik "Demokratska Inicijativa" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Dragan Petkovic**.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Partesh, që ky vendim t'i komunikohet **z.Nikolla Tasic**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Partesh, të datës 08.05.2017, Nr.415/2017 për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Dragan Petkovic, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimin të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirënditur, i cili është z.Nikola Tasic, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 11.05.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

